



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 172/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes se posterave në vendet publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Kaçanik, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kaçanik i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimet të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me 14 qershor 2012 rreth orës 16:45, militantë të subjektit politik LDK-së kanë vendosur posterë të kandidatit për kryetar të Kaçanikut Sahit Bela në dy muret e stacionit hekurudhor të Kaçanikut.

Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009, dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografit si dëshmi.

PZAP-i, më shkresën 172/2 datë 15.06.2012, e informoi subjektin politik LDK në lidhur me ankesën në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 16.06.2012, në ora 12:00.

PZAP, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK në të cilën është theksuar se pretendimet ankimore nuk qendrojnë për shkak se posterit në fjalë nuk është i vendosur në stacion ashtu siç pretendohet nga pala ankuuese. Sipas përgjigjejes në ankesë posterit i cili shihet nga fotografit është i vendosur në muret e objektit të pa

përdorur i cili gjendet në afërsi të stacionit dhe se ky objekt nuk është i përdorshëm i cili nuk është në mëshirën e askujt. Më tej theksohet në përgjigje të ankesës se ky objekt është përdorë edhe në zgjedhjet paraprake nga të gjitha subjektet politike dhe asnjëherë nuk ka pas kurrfarë vërejtjesh nga askush e as nga përgjegjësit e stacionit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se posterat e kandidatit për kryetar komune të Kaçanikut Sahit Bela nga radhët e subjektit politik LDK janë vendosur në dy muret e objektit të stacionit e që është në kundërshtim me nenin 3.1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika “b” të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik LDK është shkelur neni 3 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihen qartë posterat e kandidatit për kryetar të komunës së Kaçanikut nga radhët e subjektit politik LDK janë të vendosura në objekt publik këtë fakt e pranon edhe vetë subjekti politik LDK në përgjigje të ankesës e datës 172/3 datë 16.06.2012 kur deklaroi se “ ky objekt edhe në zgjedhjet paraprake është përdorur nga të gjitha subjektet dhe asnjëherë nuk ka pas kurrfarë vërejtjesh nga askush e as nga përgjegjësit e stacionit” si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 172/2012 më datën 18.06.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Vlastimir Dimić**

